



**Raporti i punës i zyrës së transparencës për vitin 2024
Komuna e Hanit të Elez**

Raporti i punës së zyrës së transparencës për vitin 2024

Zyra e transparencës në përputhje me planin e aprovuar të veprimit për vitin 2024, aktivitetin e vet e ka zhvilluar në kryerjen obligimeve në fushën e informimit publik sa më të mirë si të qytetarëve të komunës ashtu edhe opinionin sa më të gjerë për të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me zhvillimet në komunën tonë.

Zyra e transparencës punën e saj e mbështetë nga obligimet që dalin në bazë të dispozitave të Udhëzimit administrativ nr. 04/2020 për Transparencën në Komuna, Planit të veprimit për Transparencë 2023-2026, të dispozitave të UDHËZIM ADMINISTRATIV (MAPL) NR.04/2023 PËR ADMINISTRATË TË HAPUR NË KOMUN dhe LIGJI NR. 03/L-215 PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE si dhe të dispozitave të Statutit të Komunës së Hanit të Elezit

Në vazhdim të aktiviteteve që kanë dalë nga këto obligime, zyra e transparencës ka bërë informimet dhe njoftimet me kohë që dalin si obligime ligjore nga Rregullorja për transparencë, njoftimet me kohë për debate publike tematike, në të cilën janë propozuar për debat dokumentet e dala nga Kuvendi i Komunës.

Zyra e transparencës ka informuar me kohë lidhur me aktivitetet e organeve të komunës së Hanit të Elezit duke publikuar informatat mbi aktivitetet e kryetarit të komunës dhe ekzekutivit, punën e kuvendit të komunës dhe trupave të saja si dhe aktivitetet tjera kulturore dhe sportive të cilat kanë qenë në interes të publikut.

Ashtu siç jeni të informuar disa herë për të gjitha problemet që lidhen me Web-faqen Zyrtare të Komunës su dhe duke iu referuar raportit vjetor i MAPL-së, raporti i KDI-së, Instituti GAP edhe viti 2024 është përcjellur me probleme të njejta.

Në Web-Faqen gjatë tërë vitit 2024 janë paraqitur probleme funksionale.

Duke qenë se në baza ditore kam marrë shumë dokumente të cilat duhej të publikohen brenda ditës si konkurse, dokumente të kuvendit, prokurimit, raporte buxhetore si dhe lajme ditore dhe për shkak të afateve ligjore kam qenë i detyruar që të njejtat ti publikoj brenda ditës kalendarike, për hirë performancës sa më të mirë të komunës jam detyruar ti publikoj vetëm pas orarit të punës dhe atë në mbrëmje pas ora 21.00

Përtej të gjitha problemeve të cilat në vazhdimësi i kam raportuar në raportet mujore nga muaji Shkurt e deri në fundë të vitit 2024, janë realizuar 1076 publikime, prej të cilave 715 dokumente dhe 361 lajme

Në përputhje me Ligjin për qasje në dokumente publike 03/L-215 dhe udhëzimeve administrative përcjellëse, zyra për informim është përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji dhe raportimin periodik të zbatimit të këtij Ligji .

Gjatë 2024 komuna e Hanit të Elezit ka pas 23 kërkesa për qasje në dokumente publike të cilat kanë marrë përgjigjeje në afatet e parapara ligjore.